



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 662 Prot.

Gjirokastër, më 18.05 / 2023

Lënda: Hapet thirrja për aplikime për EUDAT Summer School 2023 në Kajaani, Finland

Shkolla Verore EUDAT 2023, do të organizohet në Kajaani, Finlandë, 26 – 30 qershor 2023.

Shkolla synon të forcojë aftësitë e nevojshme në menaxhimin e të dhënave dhe ofron 2 pista:

- Providers Track: për administratorë të sistemit të IT-së, ose menaxher të të dhënave të institucioneve kërkimore ose akademike që kërkojnë të ofrojnë shërbime për komunitetet e tyre, veçanërisht ata që janë të interesuar të mësojnë se si të vendosin shërbimet EUDAT;
- Users Track: synon të njohë studentët e programeve Bachelor, Master, PhD ose Postdoktoraturë të angazhuar aktualisht në mjedise kërkimore, me praktikat më të fundit në menaxhimin e të dhënave kërkimore që mbulojnë ciklin e plotë të të dhënave të kërkimit.

Përmes projektit EOSC Future, 10 pjesëmarrës nga vendet e Ballkanit Perëndimor do të marrin fonde për udhëtim dhe akomodim për të marrë pjesë në këtë shkollë verore.

Përzgjedhja përfundimtare e kandidatëve do të kryhet së bashku nga EUDAT dhe EOSC Future, për të siguruar pjesëmarrje të balancuar nga të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe kualifikime të përshtatshme për ngjarjen.

Afati i fundit për aplikim është 26 maj 2023.

Më shumë rreth ngjarjes, si dhe linkun e regjistrimit mund ta gjeni në: <https://eudat.eu/summer-schools/eudat-summer-school-2023>

Prof. dr. Bektash ~~MARRA~~

REKTOR

